

Gratë në përgjithësi janë më pak të kyçura edhe në organizimin pensional edhe në shoqëri. Kjo për arsye objektive dhe subjektive. Gruaja është shumë më tepër e angazhuar rreth shtëpisë, por është në pyetje edhe tradita, sidomos tek gruaja shqiptare. Fatkeqësisht, kësaj duhet shtuar edhe Internetin dhe telefoninë celulare. Sot gratë rrinë në Internet, në rrjetet sociale dhe shikojnë televizion... thotë Nurie Kadriu, ish arsimtare e Matematikës dhe Fizikës, njëherësh aktiviste në Shoqatën e Pensionistëve

**Fillimisht prezantohuni lexueseve tonë. Kush është Nurie Kadriu?**

KADRIU: Kam lindur më 1945, që do të thotë se edhe një vit do të hyj në dekadën e nëntë të jetës. Për nga kombësia jam shqiptare, me prejardhje tetovare, kurse tash sa kohë jetoj në Shkup. Me profesion jam arsimtare e matematikës dhe fizikës. U pensionova në vitin 2000, por vazhdova të jem aktive edhe si pensioniste.

**25 vite jeni në pension dhe po aq vite aktiviste pensionale. Na flisni pak mbi këtë. Nga fillimet deri më tash.**

KADRIU: Tërë kohës kam qenë e angazhuar. Fillimisht në organizatën e femrave AFZH, pastaj në disa organizata joqeveritare, kurse nga 2013 në organizatën pensionale ku aktivisht bëj pjesë edhe sot. Në komunën time - Çair, jam anëtare e Kuvendit të Shoqatës së Pensionistëve. Jam aktive në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, ku jam zgjedhur anëtare e Kuvendit, kam qenë anëtare në Këshillin ekzekutiv, në Komisionin për sport,

INTERVISTË ME NURIE KADRIUN, AKTIVISTE SHEMBULLORE DHE E RESPEKTUAR

# JAM KRENARE ME ORGANIZIMIN PENSIONAL NË VENDIN TONË



Komisionin për jetë kulturo-zbavitëse ku jam edhe këtë mandat 2023-2027. Komisioni ka programin e tij që aprovet çdo vjet. Synimi i tij është t'ua zbukurojë jetën njerëzve të moshës së tretë. Aktiviteti bazë është organizimi i revyve të këngëve, valleve dhe muzikës ku shoqërohemi, këndojmë dhe respektohem. Kënga dhe vallja janë

shprehje e bashkëjetesës sonë pasi të gjithë jemi të njëjtë: pensionistë.

**Për momentin jeni akoma aktive. Nga e merrni energjinë për aktivitete të tilla?**

KADRIU: Energjinë e marr nga gjithçka: shoqërimi me mikeshat, familja, nga jeta... Njeriu kur dëshiron mund t'i realizojë idetë e veta, planet dhe qëllimet dhe asgjë nuk i vjen rëndë, përkundrazi. Aktiviteti sjell gëzim dhe kënaqësi dhe në atë rast vitet bëhen numra.

**Përveç në organizatën pensionale, ku tjetër merrni pjesë, respektivisht si e kaloni kohën tuaj?**

KADRIU: Marrë pjesë dhe rregullisht jam aktive në Qendrën për qëndrim ditor për moshën e tretë të Kryqit të kuq në Komunën Çair, si edhe në Dare Xhambas. Shoqërimi dhe qëndrimi aty më plotësojnë dhe frymëzojnë. Në Qendrën kemi mjaft aktivitete, kështu që secili mund të bëjë çka do dhe çka është sferë e interesit të tij: të pikturojë, të thur, të dëgjojë poezi... Në takimet tona shkëmbejmë përvoja nga më të ndryshmet. Mbahen punëtori dhe ligjëratat për ushqimin e shëndoshë, për tema të ndryshme shëndetësore, për mbrojtjen nga dhuna në familje, etj. Kohën e lirë, përveç me këto aktivitete, e kaloj duke shëtitur, lexuar, dëgjuar muzikë...

**Sa është e përfaqësuar gruaja shqiptare-pensioniste në jetën e organizuar pensionale dhe në përgjithësi në shoqëri?**

KADRIU: Pak. Edhe pse çështje e vërteta, gratë në përgjithësi janë më pak të kyçura

edhe në organizimin pensional edhe në shoqëri. Kjo për arsye objektive dhe subjektive. Gruaja është shumë më tepër e angazhuar rreth shtëpisë, por është në pyetje edhe tradita, sidomos tek gruaja shqiptare. Fatkeqësisht, kësaj duhet shtuar edhe Internetin dhe telefoninë celulare. Sot gratë rrinë në Internet, në rrjetet sociale dhe shikojnë televizion. Me fjalë tjera teknologjitë e reja sollën gjëra edhe të mira edhe të këqija. Kur kësaj iu shtua edhe pandemia nga Covid 19, gjendja edhe më tepër u përkeqësua. Të shpresojmë që do të ketë ndryshime. Për këtë qëllim angazhohen edhe shoqatat e pensionistëve dhe Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

**Për fund, çka do t'u kishit rekomanduar pensionistëve për jetë cilësore dhe të përmbushur pensionale?**

KADRIU: Para së gjithash ta ruajnë shëndetin. Të jenë aktive dhe të shoqërohen. Përmes shoqërimit jeta bëhet shumë më e bukur dhe më përmbajtësore. Aktiviteti i zbukuron ditët pensionale. Ja tash jam e ftuar më 7 dhe 8 mars të marr pjesë në tubim të grave nga më shumë vende në Tiranë, si aktiviste e njohur nga vendi ynë, me çka më nderuan mjaft. Me kënaqësi do të shkoj dhe të gjithëve do t'ju rrëfej si jemi të organizuara ne në Maqedoni, se Lidhja jonë, pas 78 vitesh, kryesohet nga një femër, se botojmë gazetë për pensionistët e tashëm dhe të ardhshëm, buletinë për revytë e mbajtura folklorike dhe manifestimet sportive, se kemi veb faqen tonë, etj. Jam krenare që kam me çka të lavdërohem.

(Bisedoi: Kalina S. Andonova)

SHP-TETOVË

## KLUBI I PENSIONISTËVE, DOMOSDOSHMËRI

Ndonëse në vendbanimet e Malësisë së Tetovës kanë mbetur një numër relativisht i vogël i pensionistëve-rreth 150 sish, si rezultat i zhvendosjes së shumë familjeve në qytetin e Tetovës dhe migrimi në shtete të tjera, prapë se prapë, dega vendore në të cilën janë organizuar ata, vazhdon të zhvillojë aktivitete që janë në të mirë të organizimit pensional. Në degën e Shipkovicës përfshihen pensionistët të fshatrave të Malësisë së Tetovës, siç janë: Shipkovicë, Gajre, Liseci, Brodeci, Veshalla dhe Bozovca. Kryetari i degës vendore të pensionistëve në Shipkovicë, Avdil Islami, për gazetën "Penzioner Plus" shprehet se në këtë degë, tek pensionistët mbretëron një entuziazëm për t'u marrë me aktivitete të organizimit pensional, por mungesa e një klubi apo ambienti për



t'u tubuar, ka bërë që takimet e degës të jenë më të ralla dhe ato mbahen në ndonjë lokal hotelier apo në ambientet e shkollës.

Sipas Islamit, Dega e Shipkovicës aktivitetet e saja gjithmonë i harmonizon me selinë e Shoqatës

së pensionistëve të Tetovës, me udhëheqësinë e saj, ndërsa ka iniciuar çështje që janë specifike për degën, për t'u dalë në ndihmë pensionistëve të vendbanimeve të sipërpërmendura. Këtu vlen të përmendet iniciativa e degës që ski-

tarët pensionistë të kësaj dege, të lirohen nga participimi i pagesës së kompensimit për shfrytëzimin e ski-ashensorëve në Kodrën e Diellit. Kërkesa i është parashtruar ndërmarrjes që menaxhon me ski-ashensorët, ndërsa nga atje ende nuk kemi përgjigje, nënvizon Avdil Islami.

Këshilli vendor i degës së pensionistëve në Shipkovicë, sipas kryetarit Islami, gjithmonë në kohë ka bërë informimin e anëtarësisë me të gjitha vendimet e mara në nivel të Shoqatës së pensionistëve. Kështu bie fjala, ndarja e ndihmave të njëhershme financiare, që si aktivitet zbatohet çdo vjet, realizohet sipas kriterëve të paracaktuara, ndërsa përfitues gjithmonë janë pensionistë me pensione të ulta dhe të tjerë që ballafaqohen me probleme të

natyrës sociale. Në këtë rrafsh, edhe ekskursionet që i realizon Shoqata e pensionistëve të Tetovës, pjesëmarrës të këtij aktiviteti janë edhe pensionistë të degës së Shipkovicës. Janë bërë përpjekje, nënvizon Avdil Islami që këtë mundësi ta shfrytëzojnë pensionistët të fshatrave të Malësisë të cilët më parë nuk kanë qenë pjesë e këtij aktiviteti pensional.

Sa i përket bashkëpunimit me Shoqatën e pensionistëve në Tetovë, dega vendore e Shipkovicës, në të kaluarën, ka zhvilluar bashkëpunim të ngushtë në të gjitha segmentet e veprimeve pensionale, vlerëson Islami, i cili është mirënjohës ndaj udhëheqësisë së Shoqatës, e cila në vazhdimësi ka pasur mirëkuptim për kërkesat dhe nevojat e Degës së Shipkovicës.

(Mursel Murseli)